



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Štrpce



Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 31/05/2021 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 29.04.2021

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit


Predrag Grbic





Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Štrpce



PROCESVERBAL

Nga seanca e të rregullt e KK-ës të mbajtur më 29.04.2021, me fillim në ora 10:00

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së
3. Prezantimi dhe shqyrtimi i raportit tremujor financiar për periudhën janar-mars 2021 dhe raportit mbi nivelin e mbledhjes së të ardhurave vetanake.
4. Krijimi i grupit punues për hartimin e planit aksionar për pjesëmarrje të publikut në aprovimin e buxhetit komunal për vitin 2022 - 2024
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit të Punës së Komitetit Komunal për Siguri në Komunitet për vitin 2021
6. Raporti i punës së Komitetit Komunal për Siguri në Komunitet për vitin 2020
7. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës

PredragGrbiq: Të respektuar koleg këshilltar, dhe të gjithë të tjerë të pranishëm. Mirëdita dhe mirë se vini në seancën e katër të rregullt të K.K. Shtërpçë. Në seancën e sotme janë të pranishëm 14 këshilltarë, dhe mund të fillojmë me rendin e ditës,. A lajmërohet dikush për fjalë? Pasi nuk lajmërohet askush e qes në votim këtë pikë e rendit të ditës ..

Konstatohet se me njëzë kemi aprovuar rendin e ditës

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e KK Shtërpçë

PredragGrbiq: A lajmërohet dikush për fjalë? Nëse nuk lajmërohet askush, vë në votim këtë pikë e rendit të ditës.

Konstatoj se me njëzë kemi aprovua procesverbalin

3. Prezantimi dhe shqyrtimi i raportit tremujor financiar për periudhën janar-mars 2021 dhe raportit mbi nivelin e mbledhjes së të ardhurave vetanake.

DanijelVuksanoviq: Ne kemi 17 programe buxhetore, tabelat na japin informata për secilin program buxhetor, të gjitha informatat janë të sakta. Nuk do të doja të zgjati, nëse ka ndonjë pyetje, unë jam këtu për t'iu përgjigjur.

PredragGrbiq: Meqenëse askush nuk po përgjigjet, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

4. Krijimi i grupit punues për hartimin e planit aksionar për pjesëmarrje të publikut në aprovimin e buxhetit komunal për vitin 2022 - 2024

PredragGrbiq: Ne këtë e kemi praktikuar shumë vite dhe do të jetë kështu edhe në këtë vit. Ne kemi marr një propozim vendim me emrat e personave që duhet të ishin në këtë grup pune. Ka një përfaqësues i secilës parti politike do të jetë në këtë grup, emrat e tjerë keni pasur mundësinë të lexoni. Unë sugjeroja që të jenë anëtarë të njëjtë si në vitin e kaluar, kështu që unë përsëri do të sugjeroja që në këtë grup janë :z. RifatRustemi, z. GaripSahiti dhe z. MiroslavDjorgjeviq.A po lajmërohet dikush për fjalë? Pasi nuk lajmërohet askush e qes në votim këtë propozim. Për takimin e grupitpunuesanëtarët do të informohen pastaj.

Konstatoj se me njëzë kemi aprovua këtë pik rendit të ditës

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit të Punës së Komitetit Komunal për Siguri në Komunitet për vitin 2021

PredragGrbiq: Ju e dini që Kuvendi e ka formua këtë Komitet, kështu që ai është i obliguar që t'i propozojë Kuvendit një plan pune. Unë thjesht do të lexoja atë që mendoj se është më e rëndësishme në lidhje me këtë plan, është që plani komunal është hartuar nga kontributi i anëtarëve të Komitetit për Sigurinë në Shtëpcë, në përputhje me obligimet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 të Ministrisë së Punës së Brendshme dhe 03/2012 të Ministrisë së Administratës së Vetëqeverisjes Lokale për Këshillat Komunale për Sigurisë së Komunitetit.

GaripSahiti: Sa i përket planit, mund të shihet se prioritetet janë të njëjta si në vitin e kaluar. Kam lexuar edhe raportin e këtij Komiteti, por nuk e di se sa ka pasur sukses në rritjen e sigurisë kur janë në pyetje shkollat, nuk e di nëse e kam pa një patrullë policie që kalonte atje gjatë gjithë vitit. Kur përmenden prioritetet, atëherë duhet të bëhet diçka për këtë. Gjithashtu rritja e sigurisë në trafik, kemi shumë automjete të paregjistruara që nuk kontrollohen. Po ashtu, kur bëhet fjalë për prerje e pyjeve, nuk kemi pasur askënd që ta punon atë punë që disa muaj, nuk kemi pylltarë. Diçka duhet të bëhet vërtet për këto çështje.

PredragGrbiq: Ka njerëz që dinë shumë më shumë se unë dhe që nuk janë të pranishëm tani, unë sigurisht do t'i përcjell këto fjalë tuaja për t'i zgjidhur këto probleme. Ne me siguri do t'i

diskutojmë këto tema kur të krijohen kushtet që të gjithë të jenë të pranishëm në seancë. E qes në votim këtë pik?

Konstatohet se me 13 vota për dhe një abstenuar e kemi aprovuar këtë pikë rendit të ditës

6. Raporti i punës së Komitetit Komunal për Siguri në Komunitet për vitin 2020

PredragGrbiq: Unë nuk mund të them asgjë në lidhje me këtë raport sepse nuk jam anëtar i të njëjtit, por po hap një diskutim. Askush nuk po lajmërohet. Kalojmë në pikën tjetër.

6. Të ndryshme.

SashaKrstiqiq: Në këtë kohë të fundit të epidemisë në territorin e komunës së Shtërpçës, 150 njerëz janë sëmur, nga të cilët 31 pacientë me gjendje klinike mesatare dhe të rëndë janë shtruar në spital. Nga 150 pacientë, 131 janë shëruar deri më sot, 17 janë pozitivë dhe 2 pacientë janë ende në spital. Unë mund të lëvdohem se nuk kemi pasur asnjë rast pozitiv në 10 ditët e fundit. Sa i përket moshës së pacientëve, ka pasur pacientë pothuajse të të gjitha moshave, kështu që përveç atyre më të moshuar, kishte edhe pacientë më të rinj, dhe kishte dy gra shtatzëna, si dhe foshnjat e tyre që kanë qenë pozitive pas lindjes. Për fat të mirë, kjo kaloi dhe ka përfunduar si duhet. Karakteristikë ishte se numri i të rinjve që u sëmurën u rrit dhe për fat të mirë nuk pati vdekje. Pavarësisht nga fakti që situata është përmirësuar ndjeshëm, ne ende duhet të jemi kujdesshëm dhe të monitorojmë situatën, t'u përmbahemi të gjitha masave të përcaktuara. Vaksinimi është forma më e mirë e mbrojtjes dhe deri më tani numri i të vaksinuarve është 774 persona me të dyja dozat e vaksinës. Ne kemi apeluar rregullisht përmes mediave që të vaksinohen sa më shumë njerëz, sepse kjo është mënyra e vetme për të krijuar imunitet kolektiv. Dëshiroj të përfitoj nga ky rast për të falënderuar Komunën e Shtërpçës, e cila, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë së Kosovës, kanë siguruar një sasi të caktuar të tretësirë e substancës infuzionit për pacientët me Covid. Fjala është për një donacion prej 300 infuzioneve të klorurit të natriumit dhe 300 infuzioneve të glukozës që na kanë ndihmuar që të kalojmë periudhën më kritike. Falënderoj autoritetet komunale, Ministrinë e Shëndetësisë në Prishtinë dhe Qeverinë e Kosovës, e cila ishte bashkëpunuese dhe ka dashur të ndihmonte.

Valmir Ahmeti: Gjatë muajit Prill, kemi pasur 9 raste pozitive dhe 1 rast vdekje. Lajmi i mirë është se vaksinimi do të fillojë javën e ardhshme, dhe do të bëhet në Dragoc.

PredragGrbić: A lajmërohet dikush për fjalë? Nëse nuk lajmërohet askush. Seanca e sotme ka përfunduar.

Procesmbajtësi
StajaMarkovic

Kryesuesi i Kuvendit
PredragGrbic

